

Për ndertimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë

**DRAFT-KONTRATË KONCESIONI E FORMËS BOT
PËR
NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE
URBANE TË QARKUT FIER DHE PRODHIMIN E ENERJISË**

MINISTRIA E MJEDISIT

DHE

Tiranë më / / 2016

KONTRATË KONCESIONI

PËR

NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER DHE PRODHIMIN E ENERGJISË

KJO KONTRATË KONCESIONI E FORMËS BOT, në lidhje me financimin, projektimit, ndërtimin, vëniën në punë, administrimin, menaxhimin e mbetjeve jo të rrezikshme urbane dhe impiantin, mirëmbajten e landfill-it, dhe prodhimin e energjise elektrike, lidhet sot në datën ___/___/2016 ndërmjet :

MINISTRISË SË MJEDISIT, (referuar si “Autoriteti Kontraktues”) i përcaktuar si i tillë referuar ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”:

DHE

Shoqërisë _____, në vijim “KONCESIONARI”

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të referohen individualisht si « **Pala** » dhe bashkërisht si « **Palët** »

DEKLARIME PARAPRAKE :

A. Autoriteti Kontraktues ka tagrat të nënshkruajë këtë kontratë në përputhje me :

1. Ligji nr. 125/2013, dt. 18.12.2006 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar,
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.575, datë 10.07.2013, « Mbi miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik/privat », i ndryshuar ,

3. Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar;
4. Ligji nr. 139/2015, “Për vetqeverisjes vendore”;
5. Ligji 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar;
6. Ligji 10448/2011 “Për lejet dhe licencat” të ndryshuar;
7. Ligji nr.8752, datë 23.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar;
8. Ligji nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
9. Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar;
10. Ligji “Për menaxhimin e integruar të ujerave”;
11. Ligjit nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja” ;
12. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
13. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 11.07.2011 “Për lëndfillin e mbetjeve”;
14. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe të planit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve”
15. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 19.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar për klasifikimin e mbetjeve” të ndryshuar;
16. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 17.09.2014 “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;
17. Udhëzimit nr. 1738, datë 12.03.2015 “Mbi kriteret e studim projektimit për rehabilitimin e vendepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e lëndfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”;
18. Urdhërit nr. 751, datë 25.11.2015 “Për ngritjen e komisionit për dhënien me konçesion/partneritet publik priivat me objekt “Ndërtimin dhe administrimin e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”;

- B. Më datën ___/___/2016, ora _____, Koncesionari ka paraqitur propozimin e tij në lidhje me këtë procedurë konkurruese (Oferta e Koncesionarit), që është pranuar nga Autoriteti Kontraktues;
- C. Më datën ___/___/2016, Autoriteti Kontraktues i ka dërguar Koncesionarit “Njoftimin e Fituesit”, (Dokumenti nr. _____ prot., ___/___/2016), Procedurat për negociimin e Kontratës u hapën zyrtarisht në datën ___/___/2016
- D. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari angazhohen në mirëbesim të vënë në zbatim këtë Kontratë Koncesioni në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara më poshtë;
- E. Koncesionari brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data efektive do të themelojë një shoqëri tregtare (Shoqëria Koncesionare), të cilës i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Kontrate.

DUKE PATUR PARASYSH SA MË SIPËR, PALET BIEN DAKORT SI MË POSHTË :

1.PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET:

1.1 Përkufizimet

Kurdoherë që fjalët me gërmën e parë të madhe do të përdoren në këtë kontratë (duke përfshirë dhe Aneksat e saj), këto fjalë do kenë kuptimet e mëposhtme :

“**Ligj**” do të thotë Kushtetuta, Marrëveshjet Ndërkombëtare të Ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, Aktet Normative me fuqinë e Ligjit, Vendimet të Këshillit të Ministrave, Aktet Nënligjore Normative të Ministrave ose Institucioneve të tjera Qendrore, aktet e Organeve të Pushtetit Vendor, dhe çdo akt tjetër normativ me fuqi juridike, si rregullore, udhëzim, urdhër, licencë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër i miratuar dhe i shpallur nga autoritetet kompetente i Republikës së Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qendror dhe/ose vendor, që janë në fuqi.

“Kontratë Koncesioni” ose **“Kontratë”**, do të thotë kjo kontratë e shkruar e lidhur mes Palëve përfshirë Dokumentat Standarte të shpallura nga Autoriteti Kontraktues, Ofertën e Koncesionarit, të gjitha Anekset dhe Formularët dhe dokumentat bashkëngjitur, të cilët përbëjnë pjesë integrale dhe të pandashme të saj pavarësisht emërtimeve që u jepen në vijim të negociatave mes Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

“Investimi” do të thotë vlera monetare totale e ndërtimit dhe pajisjes së landfillit me makineritë e nevojshme, gjate te gjithë kohezgjatjes se kontrates koncesionare përfshirë dhe rinvestimin;

“Fillimi i punimeve” do të thotë Zbatimi i projektit në landfill pas marrjes se të gjitha lejeve të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi;

“Lendfill” do të thotë fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë: një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i landfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;

“Kontratat” do të thotë të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrës për realizimin e punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt apo shërben si mjet për të bërë të mundur operimin e landfill-it dhe/ose sigurimin e fondeve financiare;

“Leje dhe Licenca” do të thotë akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi;

“Operimi” do të thotë të gjitha veprimet e koncesionarit për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe shitjen mbetjeve te riciklueshme dhe energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate;

“Sigurimi i kontratës” do të thotë vlera monetare e ngurtësuar në një llogari në cdo bankë të nivelit të dytë ose sigurimi në një shoqëri sigurimesh që operon në Republikën e Shqipërisë, me

Për ndertimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë

qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kësaj kontrate nga Koncesionari.

“Aneks” do të thotë çdo shtojcë kontratë e nënshkruar nga palët sipas rruges së miratimit të kontrates baze, si pjesë integrale dhe e pandarë e saj.

“E Drejta për Kalim” do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjese të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, me qëllimin e zbatimit të kësaj kontrate.

“Gëzim i qetë” do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar Sheshin mbështetur në studimin e fizibilitetit.

"Data e përfundimit të Punimeve" do të thotë data në të cilën lëshohet Autorizim, ose konsiderohet të jete lëshuar, sipas dispozitave të kësaj kontrate.

"Autorizim" do të thotë çdo pëlqim, leje, licencë, miratim, certifikatë apo akt i një organi shtetëror, lëshimi apo rinovimi e të cilit është përgjegjësi e organeve shtetërore, i nevojshëm për ekzekutimin e kësaj kontrate, zbatimin e projektit, përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane, ndërtimin dhe funksionimin e landfill-it, shitjen e prodhimit dhe nxjerrjen e fitimeve nga ky aktivitet, ose pagimin e ndonjë detyrimi për shërbimet përfshirë, por pa u kufizuar në to, të gjitha lejet e nevojshme sipas DSKT

"Oferta" ka kuptimin e parashikuar në pikën (B) të Deklarimeve Paraprake të kësaj Kontrate.

"Raporti përfundimtar" do të thotë Raporti që lëshohet nga Koncesionari në përfundim të punimeve të landfillit.

"Faza e ndërtimit" do të thotë periudha nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit deri në datën e përfundimit të punimeve të ndërtimit.

"**Pika e grumbullimi**" ka kuptimin që i jepet në ligjin nr.10463 datë 21.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” te ndryshuar;

"**Projekt i detajuar**" do të thotë projektimi i lëndfillit, propozuar nga Autoritetit Koncesionar.

"**Data Efektive**" ka kuptimin e përcaktuar në hyrjen në fuqi të kësaj kontrate përkatësisht pika (D) e Deklarimeve Paraprake.

"**Biogazi**" do të thotë produkti i cili do të elirohet nga depozitimi dhe dekompozimi i mbetjeve në lëndfill;

"**Kuadri ligjor mjedisor**" nenkupton aktet ligjore dhe nenligjore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, lejet në mjedis, vlerësimin e ndikimit në mjedis, menaxhimin e integruar të mbetjeve, ujërat, ajrin, tokën, floren dhe faunen, ndryshimet klimatike, kimikatet dhe substancat e rrezikshme;

"**Tarifa e mbetjeve**" do të thotë shuma e cila do të paguhet nga njesite e qeverisjes vendore të Qarkut Durrës, për çdo ton mbetje jo të rrezikshme të depozituara në lëndfill mbi të cilat do të aplikohen taksat/tarifat referuar legjislacionit në fuqi;

"**Forca Madhore**" ka kuptimin e përcaktuar në këtë kontrate;

"**Vend depozitimi**" do të thotë vendi i përcaktuar nga studimi i fizibilitetit;

"**Informimi i Publikut**" nenkupton procesin për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimarrje për mjedisin”;

"**Kërkesat e sigurimit**" do të thotë kriteret në lidhje me llojet e sigurimeve për objektin e Koncesionit bazuar në ligjin nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit në Republikën e Shqipërisë”;

"**Teste të vënies në punë (Performance)**" do të thotë teste të specifikuara në nenin 20 të kesaj kontrate;

"**Lendfill**" do të thotë impiant i ndërtuar nga Koncesionari në vendin e percaktuar sipas koordinatave të vendndodhjes së zonës së ndërhyrjes dhe më saktë në zonën e fshatit Radë, në Bashkinë e Manzës, sipas Nenit 1 të kesaj kontrate;

"**Përfundim i ndertimit të lendfillit**" do të thotë kur Koncesionari ka njoftuar me shkrim Autoritetit Kontraktues se ndërtimi i landfill-it ka përfunduar dhe se mund të fillojnë testet e performancës sipas nenit 20 të kesaj kontrate;

"**Vlera e Investimit**" do të thotë vlera totale e investimit që do të kryhet nga Koncesionari për projektimin, ndertimin, zbatimin, menaxhimin dhe operimin e projektit sipas ofertes së paraqitur;

"**Te drejtat reale të pronësisë**" do të thonë ato të drejta që mundësojnë gëzimin dhe disponimin e plotë dhe ekskluziv të shesheve dhe objekteve të lidhura me to për qëllimet e realizimit të projektit;

"**Kostot për marrjen e Shesheve**" do të thonë të gjitha shpenzimet (përfshirë edhe shpenzimet e arsyeshme për këshillim) të realizuara nga Koncesionari për shpronësimin pjesë e Sheshit që nuk është në pronësi të Autoritetit Kontraktues, ndonjë Organi Shtetëror, Republikës së Shqipërisë ose ndonjë prej organeve të pushtetit vendor;

"**Afat**" do të thotë kohëzgjatja e kontrates;

"**Shpronësim**" nënkupton asistimin e autoritetit kontraktues gjatë procedurave të shpronësimit të cilat do të zhvillohen sipas kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga koncesionari.

"**Shesh ndertimi**" nënkupton vendin ku do të ndertohej landfilli i mbetjeve për Qarkun Durrës;

1.2 Interpretimi

1.2.1 Përveç kur nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë:

- 1.2.1 Njëjési përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- 1.2.2 Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjëanëse;
- 1.2.3 Referimi tek një ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë përfshin referimin tek ai ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë sic është ndryshuar, shtuar apo rimiruar kohë pas kohe dhe tek çdo akt tjetër si rrjedhim i tyre.
- 1.2.4 Termat “të kësaj”, “këtu”, “nëpërmjet kësaj ose nga kjo”, “në këtë” dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Tabele, Bashkëlidhje ose Grafiku apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;
- 1.2.5 Parathënia dhe Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet anekset e gjithcka tjetër që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje, do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe referencat në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur Palët merren vesh ndryshe;
- 1.2.6 Çdo frazë që fillon me fjalët “përfshin” ose “duke përfshirë”, “në vecanti”, “për shembull”, “të tilla si” apo të ngjashme, do të kuptohen si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
- 1.2.7 Referencat në “këtë Kontratë” ose “kjo Kontratë Konçesioni” do të interpretohen si referenca në këtë Kontratë siç mund të ndryshohet ose modifikohet në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;
- 1.2.8 Sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri “ditësh” ky numër do t’i referohet ditëve kalendarike, përveç kur specifikohen si Ditë Pune;
- 1.2.9 Çdo referencë në “muaj” ose “vit” do të interpretohet si referencë në një muaj kalendarik ose vit kalendarik;
- 1.2.10 Cdo fjalë, term, frazë dhe shkurtim që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në ndonjë Aneks, Bashkëlidhje a Dokument tjetër bashkëngjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Aneks, Bashkëlidhje a Dokument, sipas rastit;
- 1.2.11 Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nenparagrafet, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;

- 1.2.12 Në rast mospërputhjeje midis çdo fjale me germë të madhe, termi të përcaktuar, fraze ose shkurtime të parashikuara në Nenin 1.1 dhe një dispozite, fjale me germë të madhe, termi, fraze ose shkurtime parashikuar gjetkë në këtë Kontratë, Aneks, Bashkëlidhje ose në një Dokument tjetër bashkangjitur tek çdo Bashkëlidhje, kuptimi i dhënë në Nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo Aneks, Bashkëlidhjeje a një Dokument tjetër bashkangjitur çdo Bashkëlidhjeje, përveç kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;
- 1.2.13 Nje referim tek nje ent shtetëror nenkupton referencen tek juridiksioni i tij dhe nese ky ent shtetëror:
- zevendesohet nga nje organ/ent tjetër, ateherë i referohet juridiksionit te ketij te fundit;
 - pushon se ekzistuar, atehere i referohet juridiksionit te organit/entit, i cili ka kompetenca te perafërta ose te njejta me organin/entin shtetëror qe ka pushuar se ekzistuar;
- 1.2.14 Kudo në Kontratë dhe në gjithë dokumentacionin bashkëngjitur asaj, termi “Konçesionar” do të nënkuptojë njëkohësisht edhe termin “Shoqëri Koncesionare”.
- 1.2.15 Pa paragjykim ndaj paragrafeve te mesiperm, nese ka ndonje konflikt apo mospermbushje ndermjet neneve dhe Anekseve dhe/ose ndonje shtojce te Anekseve dhe/ose cdo dokumenti tjetër qe i referohemi ne kete Kontrate, konflikti apo mosperputhja do te zgjidhet sipas rendit te meposhtem te perparemise, duke bere interpretimin me mirebesim, nisur nga qellimi qe kane patur Palet:
- Kerkesat e Autoritetit Kontraktues (Dokumentat Standarte te Tenderit);
 - Oferta e Koncesionarit, përfshirë dhe zgjidhjen teknike;
 - Kontrata Koncesionare, Anekset dhe cdo dokument tjetër bashkëlidhur ku Kontrata Koncesionare bën referencë.

NENI 1

Objekti dhe Vendodhja e Koncesionit

Autoriteti Kontraktues, nëpërmjet kësaj kontrate dhe në përputhje me kushtet e saj, i jep Koncesionarit të drejtën për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë të impiantit, administrimin, menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane jo te rrezikshme dhe mirëmbajtjes se landfill-it, grumbullimit dhe përdorimit të mbetjeve për prodhimin e energjisë elektrike dhe transferimi ne fund te periudhes koncesionare nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, të impiantit të incenerimit.

a- Rregullimi i marrëdhënieve mes Autoritetit Kontraktues dhe koncesionarit lidhet me:

- marrjen në dorëzim të terreneve mbi të cilat do të ngrihet impianti dhe transferimin në përfundim të koncesionit, tek Autoriteti Kontraktues;
- kryerjen e punimeve për përgatitjen dhe vënien në siguri të zonës së kantierit për fazat e mëtejshme të realizimit të veprës;
- realizimin e gjithë punimeve të nevojshme për depozitimin e mbetjeve jo te rrezikshme të ardhura nga të gjithë bashkitë që bëjnë pjesë në Qarkun e Fierit;
- operimin e impiantit për 6 (gjashtë) vjet;

b- Zona në të cilën shtrihet ky koncesion është zona brenda kordinatave të përcaktuar në ofertën e koncesionarit.

NENI 2

Kontrata e Koncesionit

Kontrata e Koncesionit nënkupton marrëveshjen e nënshkruar midis koncesionarit dhe autoritetit kontraktues, duke pranuar kështu kushtet, të drejtat, detyrimet, ofertën e koncesionarit, dokumentat standarte si dhe anekset që do të bashkëlidhen me të, si pjesë perberese dhe e pandare e kësaj kontrate si më poshtë :

- a) Dokumentat dhe dokumentacioni i procedurës konkurruese publikuar nga Ministria e Mjedisit në datë _____ 2016;
- b) Dokumentet lidhur me ofertën e paraqitur brenda datës _____ nga Shoqëria, që ndër të tjera përmbajnë listën e skicave të projektit, ndër to:

- c) vendndodhja e zonës së ndërhyrjes dhe më saktë e zonës në fshatin Portez, në Bashkinë e Fierit,
- d) projekti teknik dhe i përgjithshëm, me relacionet e tij;
- e) Plani Ekonomik Financiar;
- f) dokumenti përmbledhës i llogaritjes së tarifës dhe pagesave;

NENI 3

Periudha e Koncesionit

- 3.1 Koncesioni sipas kësaj kontrate jepet për një periudhë 6 (tgjashtë) vjeçare (Periudha Koncesionare), e cila fillon nga Data Efektive. Në rast se Koncesioni zgjatet nga Autoriteti Kontraktues, për shkaqe të parashikuara në këtë kontratë, tej periudhës në vite të përcaktuar këtu më sipër, Periudha Koncesionare do të përfshijë dhe periudhën shtesë. Në rast se Koncesioni përfundon para periudhës në vite të përcaktuar këtu më sipër, për shkaqe si zgjidhja e kontratës apo shkaqe të tjera që çojnë në përfundimin e saj, Periudha Koncesionare do të kufizohet në periudhën nga Data Efektive deri në datën e përfundimit të Koncesionit.
- 3.2 Periudha Koncesionare mund të shtyhet në rastin e Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur ngjarja e Forcës Madhore dhe kohën e arsyeshme për riparimin e dëmeve të shkaktuara.

NENI 4

Deklarime dhe garanci të palëve

4.1 Deklarime të Koncesionarit :

- a) Koncesionari do të themelojë brenda 45 (dyzet e pesë) ditësh nga nënshkrimi i kësaj kontrate, një shoqëri të re në Republikën e Shqipërisë e cila do të ketë për ortakë/aksionarë, pjesëmarrësit në bashkimin e përkohshëm të shoqërive, sipas përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive me objekt ekskluziv, përmbushjen e kësaj kontrate koncesioni.
- b) Me themelimin e shoqërisë së re koncesionare konsiderohet se të gjitha të drejtat e detyrimet objekt i kësaj kontrate i kalojnë shoqërisë koncesionare. Pavarësisht kësaj,

- shoqerite e bashkimit te perkoheshem te shoqerive do të jenë solidarisht përgjegjës në raport me autoritetin kontraktor, për çdo mospërbushje të kontrates koncesionare.
- c) Shoqëria koncesionare do të jetë titullare e shërbimit në impiantin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane jo të rrezikshme, shitjes së mbetjeve të riciklueshme që u shërben të gjithë bashkive që bëjnë pjesë në Qarkun e Durrësit;
- d) Koncesionari është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, menaxhimin, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin të kontrolluar sanitar të mbetjeve urbane jo të rrezikshme dhe përdorimin e energjisë elektrike dhe mbetjeve të riciklueshme në lëndfill për Qarkun e Fierit;
- e) Koncesionari duhet të zbatojë me korrektësi legjislacionin fiskal të Republikës së Shqipërisë, gjatë të gjithë periudhës kohore të shtrirjes së vlefshmërisë së kësaj kontrate, për veprimtarinë e ushtruar prej tij si objekt i kësaj kontrate. Në rast paqartësie në kuptimin e legjislacionit tatimor për zbatimin e tij me korrektësi, siç përcakton edhe legjislacioni në fuqi, ai ka të drejtën të informohet nga organet përkatëse tatimore, qendrore apo vendore, për çdo detyrim tatimor që lind për shkak të veprimtarisë së koncesionit. Gjithashtu, nuk konsiderohet i nevojshëm konfirmimi nga autoriteti kontraktor i taksave dhe tarifave të vendosura me akte normative nga njësitë e qeverisjes vendore.
- f) Ka bere dhe do te beje kerkimet dhe studimet e tij per zbatimin dhe permbushjen e detyrimeve te tij bazuar ne kete Kontrate, duke perfshire informacionin e vene ne dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, dokumentet standarte, dhe cdo lloj informacioni te kerkuar nga Koncesionari perpara dates se lidhjes se kesaj Kontrate.
- g) Eshte ne dijeni te plote persa i perket permbajtjes dhe kerkesave te Autoritetit Kontraktues te Percaktuar sipas legjislacionit ne fuqi dhe anekseve perkatese.
- h) Ka te gjithe informacionin, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshem dhe te kualifikuar me qellim qe t'i jape mundesi atij te zbatoje detyrimet qe rrjedhin nga kjo Kontrate, duke perfshire mundesine per te permbushur dhe realizuar Projektin Koncesionar.
- i) Ne asnje rast nuk do te kerkoje ndonje demshperblim, penalitet apo te ngreje cfaredo lloj pretendimi ne lidhje me zbatimin e Kontrates ndaj Autoritetit Kontraktues, apo Enteve Shteterore te tjera, per fakte, rrethana apo ngjarje qe ka dijeni dhe/ose duhet te ishin parashikuar ne projektin dhe oferten e koncesionarit.

- j) Te gjitha kontratat qe do te lidhen nga Koncesionari me te trete nuk do te kene periudhe vlefshmerie me te gjate se 3 (tre) muaj pas perfundimit te Periudhes Koncesionare.
- k) Bazuar nenit 46, të ligjit nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, koncesionari, që operon ose ka për qëllim të operojë një incenerator, në përputhje me lejen e mjedisit, duhet të disponojë dhe të sigurojë të gjitha mjetet financiare të nevojshme për të mbuluar kostot e ndërtimit, të operimit, të mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm të lëndfillit pas mbylljes së tij, përfshirë pagesën e garancisë për kostot e mbylljes së tij, ndërhyrjet e mëpasme dhe rehabilitimin e mjedisit. Periudha e nevojshme për kujdesin e mëtejshëm për inceneratorin është të paktën 6 vjet.
- l) Koncesionari garanton sigurimin e kontrates ne masen 10% te vleres se investimit, sipas dokumentave te procedurës konkurruese.

4.2 Deklarime te Autoritetit Kontraktor:

- 4.2.1 Në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë në rast ndarje, bashkim ose ndryshim portofolësh eventuale sipas ligjeve në fuqi, shprehja “Autoritet Kontraktor”, sipas kësaj kontrate koncesionare do t’i referohet ministrit përgjegjës të ngarkuar për drejtimin e politikave të mjedisit dhe ministrit përgjegjës të ngarkuar për drejtimin e politikave të infratsruktures ne Republikën e Shqipërisë.
- 4.2.2 Te gjitha te dhenat e tij te vena ne dispozicion te Koncesionarit duke perfshire dhe Dokumentet e Procedures Konkurruese, jane te sakta, te verteta dhe pa gabime.
- 4.2.3 Kjo Kontrate eshte nenshkruar rregullisht nga Autoriteti Kontraktues, i cili gezon te gjitha te drejtat dhe kompetencat ne baze te legjislacionit shqiptar.
- 4.2.4 Nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate i nenshtrohet ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise.
- 4.2.5 Do të beje te gjitha perpjekjet per te asistuar dhe ndihmuar Koncesionarin dhe/ose Shoqerinë Koncesionare gjatë procedurave për pajisje me Leje, licensa, si dhe për të sheshuar mosmarrëveshjet me autoritete të ndryshme, përfshirë dhe ato vendore.
- 4.2.6 Autoriteti Kontraktor, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për rregullimin e licencimit e veprimtarisë objekt kontrate, garanton projektin e koncesionarit mbi zonën e mbulimit mbeshtetur ne ligjin Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe planin kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

NENI 5

Sigurimi i Kontratës

- 5.1 Koncesionari me qëllim përmbushjen e detyrimeve gjatë ekzekutimit të Kontratës, do ti ofrojë Autoritetit Kontraktues një Sigurim Kontrate të parevokueshëm, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të rinovueshëm në mënyrë periodike, në ngarkim dhe me shpenzimet e shoqërisë koncensionare dhe të pagueshëm me kërkesën e parë, në formën e një police sigurimi të pakushtëzuar të lëshuar nga shoqëri sigurimi shqiptare ose në formën e një garancie bankare të parevokueshme dhe të pagueshme me kërkesën e parë, të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë e licensuar në Republikën e Shqipërisë 10% (dhjete) të shumës _____ leke që i korrespondon Vlerës së Investimit.
- 5.2 Koncesionari do të jetë përgjegjës për plotësimin e shumës së Sigurimit të Kontratë sa herë që kjo shumë preket sipas kësaj Kontrate për kryerje pagesash në favor të Autoritetit Kontraktues. Ky plotësim do të kryhet brenda 3 (tre) javësh nga data e dorëzimit tek Koncesionari të një njoftimi me shkrim në lidhje me një prekje të plotë ose të pjesshme të Sigurimit të Kontratës. Në rast mosplotësimi në afat, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e një dëmshpërblimi të barabartë me shumë e Sigurimit të Kontratës.
- 5.3 Garancia e Kontratës duhet të jetë në fuqi nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 90 ditë pas datës së përfundimit të Kontratës.

NENI 6

Njësia e Zbatimit të Projektit

- 6.1 Brenda një muaji nga Data Efektive, me Urdher të Ministrit të Mjedisit krijohet Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar ("NjZP") në Ministrinë e Mjedisit, me qëllim monitorimin e zbatimit të fazave të ndryshme të projektit dhe operimin e landfillit. Perberja dhe përgjegjesite e NjZP percaktohen në Urdhrin e Ministrit. Në përbërjen e saj do të ketë një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, një nga Bashkia Fier dhe dy përfaqësues nga koncesionari
- 6.2 Veprimtaria e NjZP do të vazhdojë të ekzistojë gjatë gjithë Periudhes Koncesionare.

NENI 7

Data Efektive e Kontratës

Data Efektive e kësaj kontrate do të jetë data e hyrjes në fuqi pas nënshkrimit nga palët .

NENI 8

Çështje Financiare

8.1 Tarifa e Koncesionit

8.1.1 Autoritetit Kontraktues detyrohet të paguajë Konçesionarit një tarifë mujore të barabartë me _____ (para tatim fitimit dhe duke përjashtuar TVSH-në) që nga momenti i lidhjes së kontratës deri në përfundimin e saj me qëllim mbështetjen financiare të projektit.

8.1.2 Detyrimi i Autoritetit Kontraktor për pagesën fillon nga Data e fillimit të punimeve.

8.2 Tarifat e Shërbimit

8.2.1 Bashkia e Fierit nuk ka detyrim të paguajë asnjë tarifë për depozitimin në impjant të mbetjeve të krijuara gjatë kohës së operimit të impjantit deri në përfundimin e kontratës dhe dorëzimin e objektit të kontratës.

8.2.2 Konçesionari ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje me të tretë të ndryshëm nga njësitë vendore të Qarkut të Fierit me qëllim depozitimin e përpunimin e mbeturinave në impjant..

NENI 9

Vlera e Investimit

Vlera që Koncesionari do të investojë në këtë Koncesion është _____ lek pa TVSH.

NENI 10

Vlera e Riinvestimit

Koncesionari detyrohet të paraqesë një plan riinvestimi për 3 vitet e fundit të afatit të koncesionit, duke parashikuar dhe një vlerë (në minimum _____ %) kundrejt vlerës së makinerive, pajisjeve. Riinvestimi duhet të kryhet në fushat e modernizimit të makinerive dhe pajisjeve si dhe infrastrukturës së nevojshme për këtë projekt dhe në përputhje me projektin e propozuar.

NENI 11

Nënkontraktimi

- 11.1 Koncesionari merr përsipër të kryejë punimet, të cilat rregullohen me këtë kontratë, nën kujdesin e vet dhe me shpenzimet e veta, duke i kryer vetë apo përmes të tretëve, të kontrolluar prej tij, sipas përcaktimeve të legjisllacionit shqiptar mbi kontrollin e shoqërive, të cilat gëzojnë aftësitë e nevojshme.
- 11.2 Veprimtaritë e kontraktuara mund të jenë objekt nënkontraktimi brenda kufijve të lejuara nga ligji dhe kjo kontratë, në mënyrë që të favorizohet përdorimi i shoqërive dhe krahut të punës vendas. Sidoqoftë, kontraktime të mundshme në subjekte të treta duhen kryer duke respektuar dispozitat në fuqi në lidhje me kontraktimet e punimeve tek të tretët nga ana e Koncesionarit.
- 11.3 Koncesionari mund të nënkontrakttojë një ose disa prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, me anë të lidhjes së një kontrate për këtë qëllim dhe pas miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktues, miratim i cili do të jepet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e vënies në dijeni nga Koncesionari. Ky miratim nuk do të refuzohet apo vonohet pa shkaqe të arsyeshme. Në rast se, Autoriteti Kontraktor nuk kthen përgjigje brenda afatit të sipërshënuar, nënkontraktimi do të konsiderohet i miratuar. Parashikimi më sipër lidhet me nënkontraktimin në bllok të

veprimtarive objekt kontrate, ndërsa palët bien shprehimisht dakord se koncesionari ka lirinë kontraktore të lidhë kontrata të ndryshme, të tilla si, kontrata sipërmarrje, furnizimi, transporti etj. me qëllim implementimin e projektit.

11.4 Pavarësisht nga nënkontraktimet e detyrimeve nënkontraktorëve, Koncesionari do të jetë i vetmi përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues për përmbushjen e kësaj Kontrate dhe Koncesionari do të garantojë Autoritetin Kontraktor ndaj çdo pretendimi apo kërkesë të paraqitur nga çdo nënkontraktor.

11.5 Koncesionari do të njoftojë Autoritetin për Nen-Kontraktuesin me informacionin e mëposhtem:

- a) Emrin e tij, Eksperiencën dhe adresën;
- b) Qellimet për të cilat nen-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nen-kontraktuesi i propozuar;
- c) Vlerën e nenkontrates;

11.6 Koncesionari nuk lejohet në asnjë rast të nënkontrakttojë shërbimet thelbësore të Koncesionit.

NENI 12

Të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit

Krahas detyrimeve të tjera në këtë Kontratë, në përputhje dhe respektim të legjislacionit në fuqi, dhe siç specifikohet në këtë Kontratë, Koncesionari përmbush, por nuk kufizohet, në detyrimet si më poshtë:

- 12.1 Do të marrë në dorëzim zonën e përcaktuar bazuar në nenin 2 të kësaj kontrate;
- 12.2 Do të kryejë punimet e vënies në siguri të zonës për përgatitjen e kantierit, me detyra dhe përgjegjësi në ngarkim të vet;
- 12.3 Do të krijojë infrastrukturën e nevojshme për depozitimin e mbetjeve;
- 12.5 Do të kryejë, në përfundim të operimit të impiantit.

Për ndertimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë

-
- 12.6 Do të krijojë një sistem menaxhimi mbetjesh, që do të ndihmojë në reduktimin e mbetjeve që do të depozitohen në lëndfill dhe në arritjen e objektivave kombëtare të caktuar nga Strategjia dhe Plani Kombëtar i menaxhimit të mbetjeve brenda kufijve teknikë të projektit;
 - 12.7 Do të organizojë procesin e grumbullimit, trajtimit dhe transportit të mbetjeve brenda territorit të impiantit;
 - 12.8 Do të krijojë një ambient që nxit arritjen e objektivave për riciklim;
 - 12.9 Do të ngrejë sistemin e rrjetit kullues dhe të drenazheve të ujërave që grumbullohen në lëndfill nga rreshjet e shiut dhe menaxhimin e tyre sipas standarteve mjedisore dhe kushteve të percaktuara në lejen e mjedisit;
 - 12.10 Do të ngrejë sistemin e kapjen energjisë elektrike;
 - 12.11 Do të ngrejë infrastrukturën shtesë të lëndfillit (peshore, rrethimin e jashtëm, pemëzimin, ndërtesën e shërbimeve, mjetet dhe makineritë që do të shërbejnë në lëndfill (rul me dhëmbë etj.), lavazhin, sistemin antizjarr, ndriçimin e jashtëm);
 - 12.12 Do të caktojë mënyrat dhe pajisjet që do të përdoren për të zvogëluar impaktet e shkaktuara nga ky aktivitet (pluhuri, zhurmat, aromet);
 - 12.13 Do të bëjë Planimetrinë në kantier ku tregohen pajisjet, objektet e shërbimeve dhe ato të rrjetit të monitorimit;
 - 12.14 Planimetria e plotë në kantier e projektit (shkalla 1:1000 ose 1:500), ku janë të paraqitura dimensionet dhe, gjithashtu, kuotat e bazës kundrejt zonës përreth dhe ndonjë objekti të mirëpërcaktuar të afishuar në objekt;
 - 12.15 Do të bëjë studimin gjeolog - inxhinierik, hidrogjeologjik dhe kushtet sizmike të zonës (ku të përfshihen materialet teknike përkatëse);
 - 12.16 Do të përgatisë Grafikun e punimeve dhe të shërbimeve;
 - 12.17 Koncesionari do të marrë përsipër shmangien e impakteve negative për shëndetin e njeriut dhe të mjedisit dhe është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar, si rezultat i shkeljes së ligjit apo veprimeve të tjera me faj, në përputhje me ligjet në fuqi.
 - 12.19. Koncesionari është përgjegjës për zbatimin dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve të percaktuara në lejet, licensat dhe autorizimet e dhena për këtë veprimtari;
 - 12.20. Koncesionari pranon dhe garanton mbulimin e pandërprerë me polica sigurimi të përshtatshme të aseteve dhe mjeteve të punës për rreziqe të dëmtimit e humbjes së këtyre të fundit në përputhje me ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe

risigurimit në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Krahas të drejtave të Koncesionarit të shprehura në objektin e kësaj kontrate dhe në përmbajtje të ligjeve në fuqi, koncesionari ka të drejtë të zgjidhe këtë kontratë në rastet vijuese:

- 12.21. Mospajisja ose vonesa e paarsyeshme në kapërcim të afateve ligjore me Autorizime (duke përfshirë Liçencat) të nevojshme për Koncesionarin, për qëllime të përmbushjes së duhur nga Koncesionari të detyrimeve të tij dhe zbatimi i të drejtave të tij sipas kësaj kontrate, me kusht që Koncesionari të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe të ketë informuar paraprakisht Autoritetit Kontraktues për këtë qëllim në përputhje me parashikimet e kësaj marrëveshje për njoftimet e mospërmbushjeve;
- 12.22. Pamundësia e koncesionarit për të lidhur kontrata me bashkitë e Qarkut Fier, për shkak të mungesës së këtyre të fundit për këtë qëllim dhe pavarësisht përpjekjeve dhe/ose ndërmjetësimit të Autoritetit Kontraktues në këtë drejtim.
- 12.23. Shpronësimi, kërkimi, konfiskimi ose shtetëzimi i të drejtave të Koncesionit qoftë edhe në rastin e interesit publik;
- 12.24. Ndalimi ose kufizimi mbi transferimin e fitimeve të Koncesionarit dhe shërbimit të huasë nga Republika e Shqipërisë (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet e shkëmbimit valutor).
- 12.25. Ndryshime në legjislacion që ndalojnë dhe/ose ndryshojnë thelbësisht kushtet e zhvillimit të aktivitetit dhe/ose ndonjë nga zërat e tij, duke përfshirë këtu edhe importin e eksportin e çdo lënde të parë/pajisjeje të nevojshme për këtë qëllim, apo ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme parashikimet e plan biznesit të Koncesionarit.

NENI 13

Koha e Ndërtimit dhe vënies në Shfrytëzim të Impjantit

- 13.1 Koha e ndërtimit dhe e vënies në shfrytëzim të veprës është periudha nga momenti kur Kontrata e Koncesionit ka hyrë në fuqi deri në datën e fillimit të operimit të impiantit.

- 13.2 Pas dates se hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit, Koncesionarit do t'i duhet te pajiset me të gjitha lejet qe kerkohen nga Legjislacioni ne fuqi, te nevojshme per ndertimin dhe operimin e impiantit.
- 13.3 Afati i pajisjes me lejet, licensat dhe autorizimet e nevojshme te koncesionarit është jo më shumë se 12 muaj. Pavarësisht këtij parashikimi, detyrimi i koncesionarit konsiston në aplikimin në përputhje me ligjin në fuqi për pajisjen me lejet dhe autorizimet apo dokumentacionin tjetër të nevojshëm. Autoriteti kontraktues zotohet të asistojë sa është e mundur ne pajisjen e koncesionarit me lejet dhe autorizimet e nevojshme me qëllim respektimin, e nëse është rasti edhe shkurtimin e afateve.
- 13.4 Koha e ndërtimit të impiantit është periudha nga çasti kur koncesionari fillon veprimtarinë e ndertimit deri në castin e vënies në shfrytëzim të impiantit. Për të shmangur cdo dykuptimësi, cdo afat për fillimin e ndërtimit, do të kushtëzohet nga pajisja e koncesionarit me të gjitha lejet dhe autorizimet e nevojshme për këtë qëllim.

NENI 14

Testimi i punimeve të impiantit nga Autoriteti Kontraktues

- 14.1 Kur Koncesionari konsideron se Projekti i impiantit ka perfunduar dhe është gati për t'u testuar, ai do të paraqesë kërkesën në Autoritetin Kontraktues për testimin e Projektit dhe Palët do të ndjekin zbatimin e Procedurave të Testimit.
- 14.2 Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune në nivel ekspertësh me përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, në përbërje të cilit do të ketë edhe eksperte të institucioneve të specializuara përgjegjëse dhe përfaqësues të pavarura të fushës, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të Projektit, brenda 30 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.

- 14.3 Nëse Konçesionari i kalon me sukses procedurat e testimit, Autoriteti kontraktues do të lëshojë një autorizim perkates.
- 14.4 Autorizimi konfirmon zhvillimin dhe realizimin e projektit në përputhje me këtë Kontratë.
- 14.5 Në rast se gjatë procesit të testimit, Autoriteti konstaton mospërputhje në realizimin e projektit apo të nivelit të shërbimeve, ai evidenton mospermbushjet dhe le afat per korigjimin e tyre. Ne rast mospermbushje edhe pas ketij afati atehere Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të refuzojë lëshimin e Autorizimit.
- 14.6 Nëse Koncesionarit nuk i jepet Autorizimi nga Autoriteti Kontraktues pas përfundimit me sukses të testimit, pas nje periudhe prej 30 dite pune, atehere projekti do të konsiderohet i realizuar në përputhje me Kontratën, pavarësisht datës se lëshimit të Autorizimit.
- 14.7 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk merr pjese ne procesin e testimit brenda nje afati 15 (pesembedhjete) dite nga njoftimi me shkrim i bere nga Koncesionari, ai ka te drejte ta kryej testimin edhe pa pranine e tij duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 20 ditëve pune nga përfundimi testimit. Në këtë rast projekti do të konsiderohet i realizuar në përputhje me kontratën, pavarësisht lëshimit të Autorizimit.

NENI 15

Të Drejtat dhe Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

- 15.1 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të asistojë Koncesionarin në marrjen e lejeve, licencave dhe të autorizimeve të nevojshme, përfshirë edhe shpronësimin, për ndërtimin e impiantit dhe menaxhimin e tij;
- 15.2 Autoritetit kontraktues merr përsipër të monitorojë punët që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga Koncesionari, kushtet dhe masën, në të cilën Autoriteti Kontraktues mund

të urdhërojë ndryshime për punët dhe kushtet e shërbimit duke u bazuar në dokumentet standarte të procedurës konkurruese, ofertën e koncesionarit dhe ligjin në fuqi

- 15.3 Autoriteti Kontraktor ka të drejtën të marrë masa të tjera të arsyeshme, për të siguruar që infrastruktura të operohet si duhet dhe shërbimet të jepen në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kontraktuale, si dhe ka të drejtën për të monitoruar mekanizmat dhe trajtimin e shpenzimeve të mundshme për to.
- 15.4 Transferimi i aksioneve apo i pjesëve të kapitalit të shoqërisë koncesionare realizohet në çdo rast vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 15.5 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të kryejë pagesat mujore për realizimin e impiantit dhe përballimin e kostove të ndërtimit.

NENI 16

Kryerja e Punimeve të Vënies në Siguri dhe Përgatitja e Kapacitetit të impiantit

- 16.1 Punimet për vënien në siguri të vendit të kantonit dhe ndërtimit të impiantit duhet të kryhen në përputhje me ligjet në fuqi dhe projektin e miratuar gjatë procedurës konkurruese.
- 16.2 Koncesionari merr përsipër të realizojë ndërtimin e impiantit brenda 24 muajve nga data e fillimit të punimeve.
- 16.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e mbarimit të punimeve, Koncesionari do i dërgojë Autoritetit Kontraktues një njoftim për përfundimin e punimeve;

NENI 17

Veprimtaria e Menaxhimit Operativ në impiantit

- 17.1 Koncensionari do të kryejë veprimtarinë e menaxhimit operativ të impiantit në zbatim të kërkesave të projektit të miratuar.
- 17.3 Koncensionari është i detyruar të respektojë, normat dhe standratet kombetare në lidhje me menaxhimin e këtij shërbimi të parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi dhe kushtet e lejes së dhënë.
- 17.4 Koncensionari duhet të mbajë në lëndfill dhe të plotësojë regjistrat e ngarkimit dhe shkarkimit të mbetjeve në përputhje me parashikimet ligjore, si edhe duke i regjistruar në version elektronik dhe duke ia përcjellë Autoritetit Kontraktues.
- 17.5 Koncensionari merr përsipër të dërgojë çdo muaj raportet për mbetjet e depozituara.
- 17.6 Koncensionari duhet t'i njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues emrin e personit që do të marrë detyrën e përgjegjës të impiantit, CV-ja e të cilit, në përputhje me normat në fuqi, duhet të dërgohet paraprakisht.

NENI 18 Kontrolli

- 18.1 Autoriteti Kontraktues mund të verifikojë në çdo kohë realizimin e rregullt të punimeve të vënies në siguri dhe menaxhimit të impiantit sipas parashikimeve në ligjet në fuqi.
- 18.2 Autoriteti Kontraktues, me shpenzimet e veta ka të drejtën të kryejë veprimtaritë e nevojshme të kontrollit mjedisor.
- 18.3 Autoriteti Kontraktues me shpenzimet e koncensionarit ka gjithashtu të drejtën të kryejë rievime topografike të impiantit.

- 18.4 Emrat e drejtuesve dhe/ose teknikut të jashtëm të ngarkuar me kryerjen e veprimtarive të kontrollit dhe/ose të rievimeve brenda impiantit të trajtimit në fjalë, duhet t'i njoftohen shoqërisë Koncesionare me një njoftim paraprak prej 7 ditësh kalendarike nga Autoriteti Kontraktues. Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktues do mund të hyjnë në impiant, në ditët për të cilat është rënë dakord me Koncesionarin, për të kontrolluar rregullsinë e punimeve dhe të veprimtarive të kryera, si dhe përmbushjen e saktë të detyrimeve të parashikuara nga kjo kontrate, me të drejtën për të kontrolluar edhe regjistrat e ngarkimit dhe të shkarkimit mbetjeve jo të rrezikshme, përfshirë ato që kanë të bëjnë me kullimin e ujerave të ndotur.
- 18.5 Koncesionari duhet gjithashtu të pranojë në kantier, apo sidoqoftë në të gjitha kontrollet teknike të kërkuara, personat e ngarkuar dhe caktuar, si më lart. Koncesionari duhet t'u japë Autoritetit Kontraktues apo Organeve dhe Enteve të tjera përgjegjëse të gjitha informacionet e kërkuara dhe të japë bashkëpunimin e vet gjatë veprimtarive të kontrollit, matjes, analizës lidhur me monitorimet e impiantit, edhe duke vënë në dispozicion personelin dhe pajisjet që operojnë në impiant.
- 18.6 Koncesionari merr përsipër të raportojë duke respektuar afatet kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, lidhur me kontrollin, monitorimin dhe matjen e kryer në impiant dhe të veje ato në dispozicion institucioneve përgjegjëse.
- 18.7 Koncesionari merr përsipër gjithashtu të raportojë pa humbur kohë ndodhjen e anomalive në funksionim apo të situatave me risk të mundshëm mjedisor, sa më parë të jetë e mundur dhe sidoqoftë jo më vonë se 48 (dyzetetë) orë nga ndodhja e ngjarjes së keqfunksionimit apo riskut.

NENI 20

Perfitimi i energjisë elektrike

-
- 20.1 Palët njohin në mënyrë të ndërsjellë që projekti i autorizuar parashikon mbledhjen e energjisë elektrike të prodhuar nga impianti në një sistem të instaluar për këtë qëllim dhe se të ardhurat që vijnë nga prodhimi i energjisë elektrike do të përbëjnë pjesë të të ardhurave që do të shërbejnë për uljen e kostove të operimit. Autoriteti Kontraktues do të tregohet i gatshëm për të mbështetur koncesionarin në marrjen e çdo lejeje dhe kontrate të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike e certifikimin e impiantit si një projekt i zhvillimit të paster.
- 20.2 Koncesionari merr përsipër të realizojë sistemin e prodhimit të energjisë elektrike të prodhuar në impiant. Sistemi i kapjes do të pajiset me matës të posaçëm, të cilët do të bëjnë të mundur matjen e sasisë (dhe të karakteristikave) të energjisë të prodhuar në impiant.

NENI 21

Mospërbushjet nga ana e Koncesionarit

- 21.1 Në rastet kur gjatë kohës së operimit të impiantit, funksionimi i tij do të pezullohet për shkaqe që i takojnë vetëm shoqërisë koncesionare, Autoriteti Kontraktues, për gjatë gjithë periudhës së mos funksionimit të impiantit, bazuar kompetencave të tij do të ndermarre masat perkatëse sipas legjislacionit në fuqi ndaj koncesionarit për mos funksionimin e impiantit.
- 21.2 Sa më sipër, Autoriteti Kontraktues do të dërgojë një paralajmërim lidhur me mospërbushjen duke caktuar një afat të përshtatshëm për tu përgjigjur me argumentet e veta dhe për të eliminuar parregullsitë e konstatuara. Nëse mospërbushja do të vazhdojë, kjo marrëveshje do të mund të zgjidhet në përputhje me mekanizmin e parashikuar në kontratë për këtë qëllim.
- 21.2 Për të gjitha rastet e tilla Autoriteti Kontraktues do të zbatojë penaltetet ndaj Koncesionarit bazuar në kërkesat e nenin 29, dhe aktet ligjore në fuqi mbi të cilat bazohet ushtrimi i kesaj veprimtarie.

- 21.3 Përbëjnë shkak për zgjidhje të kësaj kontrate edhe rastet në cilat koncesionari do të ishte përgjegjëse për shkelje të rënda të ligjeve apo në realizimin e punimeve për vënien në siguri dhe të sistemeve plotësuese të monitorimit mjedisor apo të mospërbushjeve të tjera të konsiderueshme dhe të përsëritura të detyrimeve të marra përsipër me këtë kontrate. Edhe në këto raste zgjidhja do të aplikohet vetëm, pas një paralajmërimi dhe pas mosrespektimit të këtij paralajmërimi nga ana e Koncesionarit dhe procedurave vijuese të përcaktuara në këtë kontratë.
- 21.4 Duke iu referuar rastit të parashikuar në pikën e mësipërme, Koncesionari do të mbetet sidoqoftë përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktues për dëme që mund t'i jenë shkaktuar.

NENI 22

Rastet e Forces Madhore

- 22.1 Me termin “Raste të Forcës Madhore” në këtë Kontratë u referohemi çdo ngjarjeje apo fenomen natyror, të njerëzve apo një bashkim i të dyjave, i cili nuk është provokuar e nuk mund të jetë nën kontrollin e arsyeshëm të Palëve dhe që sjell një shkelje të drejtpërdrejtë apo tërthortë për sa është rënë dakord në këtë kontratë apo shkakton një dëm të plotë apo të pjesshëm në përmbushjen e cilitdo prej detyrimeve të veta që rrjedhin nga kjo marrëveshje por vetëm nëse:
- a) Kjo rrethanë, pavarësisht përjekjeve, nuk mund të parandalohet, shmangët apo eliminohet nga Pala e prekur;
 - b) Pala e prekur ka marrë të gjitha masat e arsyeshme, ka treguar vëmendjen e duhur dhe ka marrë masat alternative të arsyeshme me qëllim që të shmangët ndikimi i kësaj ngjarjeje mbi aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga kjo Kontratë dhe për të zbutur pasojat;
 - c) Ngjarja nuk rrjedh, drejtpërsëdrejti apo jo, nga një shkelje e detyrimeve siç përcaktohen nga kjo Kontratë për Palën e prekur;

- d) Pala e prekur ka njoftuar për këtë Palën tjetër;

Ngjarje të forcës madhore do të konsiderohen ato ngjarje, me kusht që të plotësojnë kriteret e specifikuar në përkufizimin e rastit të forcës madhore më sipërtë tilla si, por pa u kufizuar në rastet e mëposhteme:

- a) akte lufte, pushtimi apo akt i armikut të huaj apo akte terrorizmi, embargo, që në çdo rast që ndodhin brenda apo që përfshin Republikën e Shqipërisë;
- b) akte kryengritjeje, revolte, greva civile, greva me natyrë politike, apo një akt terrorizmi apo sabotazhi, fushatë me natyrë politike, demonstrata, bllokada e akte të tjera të shprehjes së forcës e dhunës, që ndodhin brenda Republikës së Shqipërisë e influencojnë projektin;
- c) rrufe, zjarre, tërmete, uragane, ciklone apo fatkeqësi të tjera natyrore;

Në rast ndërprerjeje të kësaj Kontrate për shkaqe të forcës madhore, në përkufizimin e sjellë më lart, pamundësia e Palës së prekur për të përmbushur detyrimet e veta nuk duhet konsideruar si “e vonuar” kundrejt sa përcaktohet në këtë Kontratë, deri kur dhe në masën në të cilën kjo ka të bëjë me ndodhjen e një ngjarjeje të forcës madhore. Rasti i forcës madhore, përveçse sa përcaktohet ndryshe në këtë kontratë, shtyn afatet kontraktore për gjithë kohëzgjatjen. Afati matet me muaj, dhe do të shtyhet deri në përfundim të muajit kur zhduken rrethanat e forcës madhore.

Në rast se një rrethanë e forcës madhore vazhdon ose në gjykimin e palëve ka mundësi të vazhdojë për një periudhë më të gjatë së 12 muaj të njëpasnjëshëm, secila palë mund të kërkojë nga tjetra zgjidhjen e kontratës për shkak të forcës madhore.

NENI 23

Procedura e Zgjidhjes së Kontratës

23.1 Zgjidhja e Kontrates nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Konçesionarit një Njoftim për Zgjidhje në qoftë se ka ndodhur një Rast Mospërbushjeje nga Konçesionari që është duke vazhduar për më shumë se tridhjetë (30) ditë pas dërgimit nga Autoriteti Kontraktues te Konçesionari të njoftimit për këtë Rast Mospërbushjeje nga Konçesionari.

23.2. Plani i Rregullimit

- a) Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas dërgimit të njoftimit nga Autoriteti Kontraktues te Konçesionari për ekzistencën e një Rasti Mospërbushjeje nga Konçesionari, Konçesionari mund t'i propozojë Autoritetit Kontraktues një Plan Rregullimi. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së tij, Autoriteti Kontraktues do të shprehet nëse e pranon ose e refuzon këtë Plan Rregullimi, si dhe do të njoftojë menjëherë Konçesionarin për refuzimin ose pranimin.
- b) Nëse Autoriteti Kontraktues e refuzon Planin e Rregullimit, Konçesionari do të ketë të drejtën e një periudhe të paktën tridhjetë (30) ditore për të ndrequr Rastin e Mospërbushjes (që nga data e njoftimit për refuzimin nga Autoriteti Kontraktues), periudhë pas së cilës Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Konçesionarit Njoftim për Zgjidhje nëse Rasti përkatës i Mospërbushjes nuk është ndrequr ende.
- c) Nëse Autoriteti Kontraktues e miraton Planin e Rregullimit, miratim i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, Konçesionari do t'i kërkohet të zbatojë me përpikmëri këtë Plan Rregullimi. Nëse Konçesionari nuk e ka ndrequr këtë Rast Mospërbushjeje në mbarim të periudhës kohore të përcaktuar në Planin e Rregullimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë t'i japë Konçesionarit Njoftim për Zgjidhje.

23.3 Njoftimi i Përfundimit

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e Kontratës do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër.

Njoftimi i Përfundimit duhet të përmbajë:

- a) Detajet e duhura duke nënvizuar Ngjarjen e Shkakut;
- b) Datën e Përfundimit, e cila duhet të jetë jo më parë se 30 ditë nga data e Njoftimit të Përfundimit;
- c) Përfundimi i Pagesës, përfshirë dhe hollësitë e llogaritjes nga kjo;

- d) Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

23.4 Pasoja te tjera te Perfundimit

23.4.1 Me njoftimin për përfundim të parakohshëm të Kontratës, Palët janë të detyruara të nisin procedurën e dorëzimit të mjediseve dhe infrastrukturës së Projektit.

23.4.2 Mbarimi i Periudhës së Koncesionit, apo përfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate (sido që të ndodhë ai), nuk duhet të çenojë të drejtat apo ligjshmërinë e çdonjërës prej palëve në këtë Kontratë e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të veprjës edhe pas përfundimit apo mbarimit të saj (kësaj Kontrate) mbi parashikimet e dispozitave përkatesë të kësaj kontrate.

23.4.3 Kontrata e koncesionit përfundon në mbarim të periudhës koncesionare siç është rënë dakort.

23.4.4 Përbëjnë shkak për zgjidhje të kontratës së koncesionit, për Autoritetin Kontraktues sipas mospërbushjes së nenit 21 të kësaj kontrate.

23.4.5 Përbëjnë shkak për zgjidhjen e kontratës së koncesionit, për Koncesionarin çdo veprim ose mosveprim që i është ngarkuar Autoritetit Kontraktues nga kjo kontrate.

23.4.6 Zgjidhja e mundshme e parakohshme e saj, nuk e çliron Koncesionarin nga detyrimi për të paguar detyrimet e përcaktuar ndaj Autoritetit Kontraktues.

Pavarësisht sa parashikohet në këtë kontratë, dërgimi i njoftimit të përfundimit dhe/ose mosmarrëveshjet për rregullimin e një shkeljeje, nuk do të pasjellin në mënyrë automatike zgjidhjen e kontratës. Çdo njoftim për zgjidhjen e kontratës do të konsiderohet si formalizim i secilës prej palëve për të zgjidhur kontratën. Zgjidhja e kontratës dhe shpërblimi eventual i dëmit përkatës do të jetë tagër ekskluziv i autoritetit të caktuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, me përjashtim të rastit për interesin publik, sipas nenit 25 të kontratës .

NENI 24

Rastet e Shtyrjes së afateve të Kontratës

Çdo fazë e projektit mund të shtyhet me ndodhjen e:

- Një Ngjarjeje të Forcës Madhore;

- Një Ngjarje të Qenies në Vonesë të Autoritetit Kontraktues;
- Zbulimit të relikeve kulturore arkeologjike, fosileve, pirgjeve të dheut për varrime dhe vendeve përkujtimore, mbetjeve artistike historike dhe çdo seksioni tjetër me rëndësi arkeologjike, gjeologjike dhe historike mbi zonën e projektit, që rezulton në punime publike të cilat ndërhyjnë në ndërtimin e përfundimit të Punimeve nga Koncesionari, me kusht që shtyrja të jetë në përpjestim me kohëzgjatjen e ngjarjes përkatëse (dhe Palët do të kenë të drejtë t'ia referojnë çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Nen mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve), ose çdo ngjarje tjetër ose ndonjë veprim/rast tjetër që konsiderohet objektivisht i drejtë në këtë drejtim e caktohet shtyrja përkatëse nga Autoriteti Kontraktues.

Nëse një pengesë jashtë kontrollit të Koncesionarit ka të ngjarë të çojë në një vonesë në realizimin e projektit ose në arritjen e ndonjë prej Periudhave të Rëndësishme, Koncesionari duhet t'i dërgojë një raport Autoritetit Kontraktues brenda tridhjetë (30) ditësh pune në lidhje me zbulimin e pengesës, duke parashtruar arsyet që çuan ose do të çojnë në një vonesë të tillë, dhe masat që do të ndiqen për të shmangur ose minimizuar vonesën në përfundimin e Punimeve nga Data e Planifikuar e Përfundimit. Autoriteti Kontraktues mbi bazën e këtij raporti autorizon me shkrim shtyrjen e cila duhet të arsyetohet në lidhje me shkaqet që e kanë shkaktuar atë. Autoriteti Kontraktues duhet të asistojë Koncesionarin për të shmangur gjithçka pengon zbatimin e projektit/Kontratës.

NENI 25

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik. Autoriteti Kontraktues duhet t'i japë Koncesionarit njoftim me shkrim për ndërprerjen dhe aktet ligjore e nënligjore ku bazohet kjo e fundit.

Në mënyrë përjashtimore nga sa parashikon kjo kontratë, zgjidhja e kontratës për interes publik ka efekt të menjëhershëm, ndërsa autoriteti i caktuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të zgjidhë pretendimet e mundshme të palëve.

NENI 26

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Koncesionari falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi Koncesionarit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

NENI 27

Vlefshmëria e Kontratës Koncesionare

Nëse një kusht apo një dispozitë e kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme apo e paligjshme apo e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Kontratës nuk ndryshohen, Palët marrin përsipër të zëvendësojnë dispozitën e pavlefshme brenda një afati të arsyeshëm.

NENI 28

Tranferimi në përfundim të Periudhës së Koncesionit

28.1 Me mbarimin e Periudhës së Koncesionit, Koncesionari do të dorëzojë tek Autoriteti Kontraktues të gjithë dokumentet e nënshkruara nga fillimi i procedurës së ndërtimit të impiantit.

28.2 Procesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 3 (tre) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit nga një inspektim i përbashkët i Autoritetit dhe Koncesionarit.

28.3 Procedura e Dorëzimit përfshin:

28.3.1 Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në:

- a) Dorëzimin fizik të impiantit të Shoqërisë Koncesionare;
- b) Dorëzimin e inventarit të Aseteve me vlerën kontabël të mbetur në momentin e dorëzimit si dhe të dhënat në posedim të tij në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me operimin e Koncesionit nga Shoqëria Koncesionare, pa pagesa, detyrime apo tarifa të mëtejshme;

28.3.2 Autoriteti bie dakort dhe merr përsipër që brenda 30 ditëve nga transferimi i të drejtave dhe titujve në lidhje me asetet dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse siç është parashikuar në paragrafët me lart, do të lëshojë Certifikatën e Dorëzimit të kësaj Kontrate. Koncesionari duhet të dorëzojë këto asete në gjendje funksionale. Ndërsa të gjitha asetet e sipërpërmendura të Shoqërisë Koncesionare do të transferohen tek Autoriteti në ditën e përfundimit të Periudhës së Koncesionit.

NENI 29

Penalitetet

- 29.1 Autoriteti Kontraktues për çdo shkelje të kësaj kontrate ka të drejtën e vendosjes së penaliteteve në shumën 2.000.000 (dymilione) lek.
- 29.2 Nëse shuma e penaliteteve kalon vlerën prej 30.000.000 (tridhjetëmilionë) lekë Autoritetit i lindë e drejta e zgjidhjes së kontratës pas procedurës së Njoftimit, përcaktuar në Nenin 23 të Kontratës Koncesionare.
- 29.3 Koncesionari për çdo penaltet të vendosur nga Autoriteti Kontraktues ka të drejtën e ankimimit tek Autoriteti Kontraktor. Në rast se brenda 30 diteve nga data e ankimit tek Autoriteti Koncesionari nuk bie dakort me përgjigjen e ankimit, Koncesionarit i lind e drejta ti drejtohet autoritetit kontraktor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

NENI 30
Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga një Palë për Palën tjetër, që kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate:

- (i) do të bëhet në gjuhën shqipe;
- (ii) do të bëhet me shkrim;
- (iii) do të dorëzohet personalisht (dorazi), ose do të dërgohet me postë rekomande të parapaguar, me korrier në adresën e Palës tjetër që jepet më poshtë, ose në ndonjë adresë tjetër të tillë, siç Pala tjetër do të kërkojë me njoftim, apo do të dërgohet me mjete të tjera që lejojnë në mënyrë të padyshimtë konfirmimin e marrjes, dhe
- (iv) shënohet në vëmendje të personit (ave) të caktuar më poshtë ose të ndonjë personi (ash), të tjerë siç Pala tjetër do ta kërkojë me njoftim.

Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga një Palë për Palën tjetër në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni do të konsiderohet të jetë marrë nga Pala tjetër nëse dorëzohet dorazi në ditën që është lënë në adresën e asaj Pale (që mund të modifikohet herë pas here pas një njoftimi të arsyeshëm nga secila Palë për Palën tjetër), nëse dërgohet me postë rekomande të pararegjistruar ose me korrier dyzetetë (48) orë nga data e postimit ose nëse dërgohet me transmetim faksi, siç parashikohet më lart.

Palët njoftojnë me shkrim rast pas rasti personat e kontaktit.

NENI 31
Ndryshimet e Kontratës

31.1 Kjo Kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar të të dy Palëve, në formën e një aneks-kontrate e cila do të ndjekë rregullin e miratimit të Kontratës bazë pa prekur elementët thelbësore të objektit të kontratës.

-
- 31.2 Secila Palë mund t'i drejtojë një kërkesë për ndryshim Palës tjetër në çdo kohë gjatë Periudhës Koncesionare. Kërkesa duhet të jetë me shkrim, e justifikuar dhe të përmbajë fakte dhe rrethana konkrete për arsyet e ndryshimit.
- 31.3 Brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pala tjetër duhet të shprehet në mënyrë të shkruar në lidhje me pranimin ose refuzimin e ndryshimeve. Afati 30 ditor përfshin të gjithë negocimin e çështjes.
- 31.4 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate apo Aneksëve bashkëlidhur, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

NENI 32

Gjuhë e Kontratës

Kjo Kontratë do të hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe. Në rast konflikti midis gjuhëve do të mbizotëroje versioni në gjuhën shqipe. Të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet Palëve në lidhje me zbatimin e kontratës do të jenë vetëm në gjuhën shqipe.

NENI 33

Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 33.1 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet në Republikën e Shqipërisë.
- 33.2 Çdo kundërshti, mosmarrveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve duke u bazuar në vullnetin e mirë.

33.3 Në rast se zgjidhja me mirëkuptim midis tyre, duke u bazuar në vullnetin e mirë dështon, atëherë mosmarrveshja midis palëve do të zgjidhet përmes gjykatës së shkallës së parë në Tiranë.

NENI 34

Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet lidhur me këtë marrëveshje, përfshirë ato të regjistrimit, si dhe të akteve dhe dokumenteve të mundshme shtesë, janë në ngarkim të Koncensionarit.

Nënshkrimi:

Në prani të të cilëve kjo Kontratë është arritur siç duhet nga Palët.

Autoriteti Kontraktor:

Nënshkruar për, dhe në emër të:

MINISTRISË SË MJEDISIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Emri:

Pozicioni: MINISTER

Adresa : Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Ish godina ATSH, Tiranë

Nënshkrimi: _____

Nënshkruar për, dhe në emër të:

KONCESIONARI

Nënshkruar për, dhe në emër të:

Emri:

Pozicioni:

Adresa:

Nënshkrimi: _____

opencorporates
Albania
The Open Database Of The Albanian Corporates

Anekset më poshtë janë pjesë e pandarë e kontratës:

ANEKSI I -

Vendimi Nr. 452, Dt.11.7.2012, "Për lëndfillet e mbetjeve"

ANEKSI II

Dokumentet standarde

Aneksi III

Oferta e Koncesionit përfshirë dokumentet ekonomik, dhe teknik.

opencorporates Albania
The Open Database Of The Albanian Corporates